

مطوية

التمدد الشيعي

باللغة الألبانية

للشيخ إبراهيم العجلان

Përhapja e Shi'izmit

Ibrahim el-Axhlan

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotit

Përhapja e Shi'izmit

Falenderimet i përkasin Allahut, Zotit të të gjitha krijesave, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi më të mirin e të dërguarëve, familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit, e siç vijon:

I nderuari vëllai im lexues: Sqarimi i rrugës së kriminelëve dhe demaskimi i strategjive të tyre, në të vërtetë është një metodikë e përdorur edhe në Librin e Zotit tonë, ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar: [الاعتراف: 55] ﴿وَكَذَلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ وَلِتَسْتَبِينَ سَبِيلَ الْمَجْرِمِينَ﴾ kuptimi: ***«Ja, kështu Ne i shpjegojmë argumentet me detaje, në mënyrë që rruga e kriminelëve të bëhet e qartë.»*** (el-En'am:55)

E nuk ka diçka më të dobishme sesa Ummeti dominues t'i kuptojë demagogjitë e atyre që dëshirojnë t'i kundërshtojnë ata, dhe se më të dobishme se kjo është njohja e strategjive dhe taktikave të tyre armiqësore në promovimin e së pavërtetës.

Le të ndalemi sëbashku - i nderuari vëllai im lexues - tek një rrezik, të cilit i ka rënë këmbana, i ka dalë tymi, i është ndezur zjarri dhe i ka dalë flaka! Ky rrezik është pikërisht përhapja e shi'izmit në botën Islame.

Kjo përpjekje e fshehtë në përhapjen e shi'izmit, tashmë është një e vërtetë aspak e imagjinuar dhe një realitet aspak i fryrë, pasi fantazma e shi'izmit nuk ka lënë shtet dhe as vend pa u futur, duke filluar që nga Japonia deri në Amerikën Latine dhe që nga Europa Veriore e deri në Afrikë.

Ky projekt tashmë po sillet rreth shtëpive duke ia hequr vellon, besimin, historinë dhe simbolet Islamit, aq sa ankesa e çdo xheloz ka arritur kulmin prej këtij Tsunami të fshehtë që sa vjen e po shtohet, veçanërisht në një kohë kur organizatat dhe fondacionet islame po kalojnë një kohë të vështirë për shkak të shtrëngimeve dhe kufizimeve ndaj tyre.

Të folurit rreth përplasjeve fetare dhe shoshitjes ideologjike, nuk është më pak e rëndësishme sesa të folurit për pushtimet ushtarake, veçanërisht kur ne po i shohim pasojat e kësaj lufte dhe ofensive, si dhe gjithçka që vjen pas tyre në lidhje me mbushjen dhe ngarkimin emocional aspak premtues për të ardhmen e sigurtë të Ummetit islam.

Përse i gjithë ky alarm në lidhje me përhapjen e shi'izmit?!

Sepse referencat mes nesh dhe mes tyre janë krejtësisht të ndryshme, dhe se rrënjët ndërmjet këtyre palëve janë po aq të largëta sa largësia mes lindjes dhe perëndimit.

E si mund të afrohem ne – o vëllai im i nderuar - me një popull i cili bën thirrje që të besohet në pagabueshmërinë e imamllarëve të Ehli Bejtit, duke pretenduar se ata e ditkan Gajbin (*të fshehtat e Zotit*). [shiko: "Usul el-Kafij" (1/f.165) i Kelijni-t].

Si dhe thonë se Kur'ani Fisnik është i ndryshuar, dhe se ky Kur'an që ne kemi përpara vetes nuk është i njëjti Kur'an që i është zbritur të Dërguarit ﷺ porse janë bërë ndryshime në të, duke u tjetërsuar, nëpërmjet të shtuarit në të apo të pakësuarit prej tij. ["Usul el-Kafij" (1/f.285)]

E si mund të afrohem me një popull, që tehet e gjuhëve të tyre i kanë lëshuar kundër shokëve të Profetit ﷺ në mënyrën më të prishur, me mallkimet më të këqia dhe me konsiderimin e tyre kufar (*mohues të Allahut dhe të Dërguarit të Tij*). [Shih çfarë përmend el-Mexhlisij në librin e vet "Bihar el-Enuar" (69/f.137-138)].

Dhe se kushdo që nuk e pranon imamllëkun e njërit prej dymbëdhjetë imamllarëve në të cilët ata besojnë, ai tek shiat imamij konsiderohet kafir (*mohues i Allahut*) dhe i devijuar, që e meriton të jetë përgjithmonë në Zjarrin e Xhehenemit. [Shih: "Hakul-Jekijn" i Abdullah Shubr/f.189]

Në një kohë që ky sekt ka një historik të errët sterrë në lidhje me Ummetin islam, dhe se armiqësia ndaj nesh është pika e tyre më e fortë, si dhe urrejtja e mllëfi i tyre ndaj nesh është ngjitesë, aq sa madje nuk ka kaluar asnjë ngjarje prej ngjarjeve historike të Ummetit tonë e që ata të mos kenë dorë në sulmet dhe qëndrimet e tyre armiqësore nëpërmjet kryengritjeve dhe pabesive të tyre.

Kjo pra është e vërteta historike e shiave batini (të *kamufluar*):

Lexojeni historinë pasi do t'i kuptoni në të urtësitë

I humbur do jetë ai popull që nuk kupton ndodhitë

Por, metodikat e tyre të turpshme, zgjerimi dhe përhapja e tyre nuk nënkupton që ne tani atyre duhet t'u bëjmë padrejtësi, apo nuk duhet të mbajmë ndaj tyre drejtësi, pasi ne jemi Ummeti i drejtësisë, i paanshmërisë, i mëshirës dhe i mesatares.

Ashti siç është e vërtetë - për Allahun - se nuk është në interesin e Ummetit thirrja për tek përballja dhe konfrontimi i sekteve, veçanërisht në këtë kohë që po jetojmë, pasi kjo është korrja e asaj që kanë mbjellur projektet e masonizimit hebre dhe i gjithë atyre që qëndrojnë pas kësaj.

Mirëpo të heshturit përballë këtij zgjerimi të dukshëm që synon poshtërimin, dhe mbyllja e njërit sy në lidhje me këtë, është në llogari të Ehli Sunnetit, dhe se këta misionarë të Shi'izmit, në të vërtetë qëllimin dhe synimin kryesor kanë vendet sunnite islame.

(1) Dijetari i tyre Nurij Tabersij ka botuar një libër me titull: "Shpjegim i deklaratës që pohon ndryshimin e Librit të Zotit të zotërve." libër i cili përmbanë më shumë se njëqind referime nga fjalët e imamllarëve dhe dijetarëve të tyre, duke pohuar me këtë se të gjithë ata e kanë pranuar në mënyrë unanime besimin se ai (Kur'ani) ka ndryshuar.

Kështu që, këto fjalë janë për të dhënë të kuptohet një projekt, siç është ai i zgjerimit të shiave, marrja seriozisht e këtij mendimi, si dhe thirrja për tek përballja me të nëpërmjet rrugëve të lejuara dhe aspak thirrja për tek konfrontimi apo lufta sektare.

I nderuari vëllai im lexues:

Ideja e përhapjes së shi'izmit ka filluar që me fillimin e pushtetit të Humejnit të shkatërruar, i cili e shpalli hapur revolucionin përmbysës të tij, duke e quajtur atë revolucionin islamik.

Ky projekt i përhapjes së shi'izmit ka filluar sinkron me epokën e re të dashurisë ndaj "fekihut" epokë e cila tek shiat nënkupton se për ndjekësit e shiave është obligim ndjekja e tarikatit imamij, duke e ndjekur kështu "fekihun" i cili është përfaqësuesi kryesor i imamit të fshehur e të pritshëm (Mehdiut).

Në lidhje me këtë në librin e vet " Shteti islamik - në fq.36", Humejni duke pohuar dogmën e dashurisë ndaj "fekihut" thotë: «...është e drejtë e fekihëve, madje është vaxhib (detyrë) dhe farz (obligim i domosdoshëm) që të angazhohen për të qenë zëvendësuesit e Imamit të kohës para Kijametit, Imamit të fshehur, si dhe të zotërojnë frenat e pushtetit si një shembull dhe përfaqësues i tij, e që këtu bëhet domosdoshmëri bindja ndaj tij, jo vetëm si një Imam por si një Nebij dhe Resul.» duke përfunduar kështu fjalën e tij.

Me këtë ideologji krijuesi i këtij revolucionin i mbajti ndjekësit e vet dhe pakicat, këtu e atje, në mënyrë që të ishin ndjekës të tij dhe zbatues të urdhërit të tij.

E me realizimin e qëllimit të revolucionit, shteti i Humejnit hyri madje në luftë për një periudhë tetë vjeçare me Irakun - të cilin Persët gjithmonë e kanë konsideruar portën e tyre për të hyrë në botën islame, duke marrë parasyshë atë çfarë përfaqësonte Iraku dhe largësinë e tij fetare me sektin e tyre -, luftë e cila përfundoi me marrjen e shumë shpirtrave të pafajshëm dhe solli një defiçit të madh ekonomik.

Pas kësaj, kjo qeveri e mullahëve, me krijimin dhe zhvillimin e saj filloi nxitjen dhe shtyrjen e pakicave shi'ite që të kërkonin pavorsi dhe të kërkonin vetëqeverisje, në disa vende islame sunite, si dhe gjatë kësaj kohe u krijuan disa parti politike shi'ite si një opozitë me qeveritë e tyre, të cilat sot në botë janë kthyer në një zë dhe po bëjnë një zhurmë të madhe, siç është: "**Partia e Thirrjes Islamike**" në Irak, "**Lëvizja e Shpresës**" e "**Hizbullahu**" në Lubnan, "**Fronti Islamik Çlirimtar**" në Bahrejn, si dhe "**Lëvizja e Huthëve**" në Jemen.

Këto parti u bindeshin vetëm Ajatullahëve të Kom-it (*vend i shenjtë për shiat*) duke u kthyer kështu në një jehonë e zërit pers - Safavij (*spastrues*).

E pasi persët dështuan që të arrinin deri tek revolucionin me anë të forcës, kryengritjeve dhe armëve, iu kthyen zgjuarsisë perse duke krijuar revolucione me anë të lëvizjeve të qeta dhe diplomatike, si dhe me një shpirt politik jetëgjatë, me një projekt të thellë dhe me një përpjekje "mundet", duke filluar kështu zgjerimi i shi'izmit nëpërmjet luftimit të vendeve islame, mosnjohjeve të kufijve dhe mosndalimit prej çdo barrjere.

Këtë projekt e financoi dhe mbështeti vetë shteti religjioz shi'it, i cili është i angazhuar maksimalisht për të arritur pushtetin e këtyre vendeve, duke vënë në shërbim të partive dhe lëvizjeve të veta, çdo mundësi, çdo fuqi, çdo shoqatë dhe çdo ekonomi të sajën për të financuar

përhapjen e kësaj ideologjie nëpërmjet një numri të jashtëzakonshëm miliardash, ku prej informacioneve të deklaruara në lidhje me këtë është se: një e pesta e të ardhurave prej naftës së Iranit shpenzohet për t'ia arritur këtë qëllimi.

Humejni në testamentin e vet – duke ua lënë amanet shiave përhapjen e shi'izmit, ka thënë: «*Sa i përket çështjes së thirrjes, ajo nuk duhet lënë vetëm në përgjegjësinë e Ministrisë së Thirrjes, përkundrazi ajo është përgjegjësi e të gjithë dijetarëve, predikuesve, shkrimtarëve dhe artistëve, të cilët e kanë për detyrë që të angazhohen, madje edhe Ministria e Jashtme duhet të krijojë kushtet e përhapjes, përcjelljes dhe sqarimit të fytyrës së zgjedhur të Islamit.*» [“Testamenti politik i Imam Humejnit” fq.40]

E sa i përket kryeministrit aktual të Iranit - Ahmadi Nexhad, ai e ka deklaruar hapur se qëllimi i regjimit iranian është përhapja e shi'izmit nëpër botë, duke e ngritur flamurin e Mehdiut të shumëpritur dhe duke e përhapur këtë ideologji, tekstualisht me fjalët:

«*Vërtetë që ky preokupim në botë, bie mbi shpatullat e republikës së Iranit*» [Marrë nga webfaqja: “Mufekeratul-Islam” (Shënime Islame)]

Ndërsa një dijetar prej dijetarëve të shi'itëve e ka deklaruar hapur në fillimin e bisedës së tij në kanalën televiziv statelitor “el-Mustakila” - me datë 23/1/2007 – duke thënë:

«*Pasuria e shi'itëve në qytetin e Kom-it dhe të Nexhf-it, është në dispozicion e gjitha, për pushtimin e të gjitha vendeve të Gadishullit Arabik, Sirisë, Jemenit dhe Irakut, dhe se qëllimi themelor është drejtimi i tërë botës Islame.*»

Pra, përhapja e Shi'izmit nuk ka kufinj dhe se ata janë të angazhuar për ta përhapur atë në të gjitha drejtimet.

*** Sa u përket rrugëve dhe mënyrave që ata përdorin për të arritur nëpërmjet tyre deri tek indoktrinimi shi'it dhe suksesi i tyre për këtë, ato janë të shumta:**

- **E para dhe më e rëndësishmja prej tyre është:**

Ndezja e ndjenjave të dashurisë për Ehli Bejtin, quajtja e lëvizjes së tyre me term ëmbëlzues si medh'hebi i Familjes së Profetit (*Ehli Bejtit*), mëkimi i thirrjes së tyre që në djepin e saj me dashurinë ndaj Ehli Bejtit, duke ua përkujtuar mirësitë e tyre, si dhe duke ua përmendur të drejtat e tyre.

Këtë thirrje, shi'itët më vonë do ta përdorin për të kaluar deri në teprim ndaj tyre dhe duke i shenjtëruar ata, si një hark me të cilin ata të sulmojnë pastaj nëpërmjet tyre (dashurisë dhe shenjtërimit) ata që sipas tyre ua kanë rrëmbyer Ehli Bejtit të drejtën e qeverisjes, apo që i kanë dhunuar dhe që u kanë bërë atyre padrejtësi, të cilët sipas tyre, ata janë Sahabët e të Dërguarit të Allahut ﷺ, duke ardhur pas kësaj faza e akuzimit, e përçmimit, e ofendimit të Sahabëve dhe e konsiderimit të tyre tradhëtarë, si dhe pastaj mallkimi i tyre derisa në fund t'i konsiderojnë ata edhe jobesimtarë.

Pra, këto emocione – që i pretendojnë se u vijnë nga dashuria për Ehli Bejtin – nuk janë tjetër vetëm se një kamuflim i këtyre misionarëve të sektit të tyre Shi'it, duke u përpjekur që me këtë të lënë një imazh të mirë.

Prandaj për këtë, organizatat e davetit dhe ringjalljes së shi'izmit – madje edhe politika – filloi të emërtohej me emrat e Ehli Bejtit, në mënyrë që të promovohet dhe të pranohet sa më shumë ky tarikat në mesin e muslimanëve.

E ndërsa sa u përket vendeve që ata i pretendojnë si varret e Ehli Bejtit, qëllimi i shi'itëve ka qenë që t'i bëjë ato vende, vende pelegrinazhi, duke ndërtuar mbi to teqe dhe duke ringjallur në to shumë prej bidateve që të nxjerrin prej Islamit, si dhe duke shtuar pikat e pushimit rreth këtyre tempujve dhe blerë tokat përreth tyre, në mënyrë që të mbesin pas kësaj, vende tërësisht shi'te.

- **Prej marifeteve të përdorura nga shi'itët në përhapjen e tarikatit të tyre, është edhe: Thirrja për tek unifikimi mes Ehli Sunnetit dhe shi'izmit.** Mirëpo në vërtetësinë e saj kjo thirrje nënkupton njohjen dhe vërtetësinë e rrugës së tyre shi'ite, e cila është një tentativë për ta bërë atë të pranueshme, si dhe ta konsiderojnë muslimanët atë rrugë si një rrugë që duhet ndjekur.

Kjo hile, për fat të keq, i ka bërë thirrësit e shi'izmit, që në brendësi të zonave Sunite ata të lëvizin në liri të plotë, me hapjen e qendrave studimore, shtëpive botuese, si dhe me përhapjen e rrugës së tyre në mesin e tyre.

E nëse bëhet fjalë për refuzimin e bindjeve të tyre të prishura apo kulturës së tyre të mbushur me mohim, këtë gjë shi'itët e konsiderojnë një përçarje që shkatërron unifikimin e muslimanëve.

Prandaj në lidhje me këtë është e drejtë e Ehli Sunnetit që të bëjnë pyetjen:

A e lejojnë mullahët e Iranit që të përhapet thirrja sunite në vendet shi'ite?!

A ka për të heshtur Persia nëse iranianët do të dëshironin të ktheheshin në sunitë?!

Si dhe a do ta lejonin ata qoftë edhe një aktivitet të tillë prej tyre në mesin e tyre?!

Kurrsesi pasha Allahun, pasi ky regjim e ndalon të mësuarit e Akides (*bazat e fesë*) Sunite madje edhe në qendrat e tyre të studimeve shkencore.

Ky regjim që sot flet fjalë boshe në lidhje me afrimitetin dhe unifikimin, është po i njëjti regjim i cili vazhdon t'i vrasë dijetarët sunitë, vazhdon t'i ndajë arabët autoktonë në parcela atje, dhe po i njëjti që i shkatërron xhamiat, i mbyll shkollat, si dhe i përndjek thirrësit e Ehli Sunnetit.

Kështu që ne, ndjekësit e Sunnetit, nuk mund të bashkohemi me një popull që i kanë përpirë veprat e kufrit të cilat e nxjerrin njeriun prej Islamit, me adhurimin e varreve dhe me vendosmërinë e tyre për të përhapur risitë devijante në fe.

- **Prej mënyrave të përhapjes së shi'izmit është gjithashtu edhe: Angazhimi i tyre në ofrimin e bursave studimore** dhe tërheqja e mijërave dhe e mijërave të rinjve muslimanë për të studiuar në të gjitha fushat e dijes, në mënyrë që të bëhen pjesë e studimeve në qendrat e tyre studimore të Teheranit, Kom-it, Mesh'hed-it dhe Tebrijz-it.

Madje qeveria e mullahëve atje, merr përsipër për ta, të gjitha shpenzimet e tyre, duke ua plotësuar atyre nevojat, duke i paguar ata për çdo gjë dhe madje duke ua mundësuar atyre edhe që të martohen atje.

Ku, qëllimi kryesor i kësaj mbështetjeje, nga ana e tyre, është konvertimi i tyre në shi'itë në rang të parë, në mënyrë që ata kur të kthehen, të jenë thirrës dhe përhapës të shi'izmit në vendet e tyre, e pastaj mos pyet për atdhetarizmin e tyre apo sinqeritetin e përkatësisë së tyre!! Kështu ata i kanë mobilizuar, për vite të tëra me mendimin se të gjitha qeveritë janë të padrejta e të papranuara nga feja, dhe se ato nuk i përmbahen vijës ideologjike të "dashurisë

ndaj fekihut", ose, sipas pretendimit të tyre, ata janë të vetmit që i përmbahen vijës së fesë origjinale të Muhammedit.

- **Prej praktikave të tyre gjithashtu janë edhe: Përhapja e thirrësve dhe dërgimi i mësuesve në përhapjen e shi'izmit,**

- 6 -

veçanërisht në vendet e largëta dhe vendet në të cilat muslimanët konsiderohen pakicë.

Njëra nga gazetat e huaja ka shkruar se regjimi iranian pas rënies së Bashkimit Sovjetik, ka dërguar qindra mësues në republikat e pavarura, duke përmendur gjithashtu se kjo fushatë i ka kushtuar qeverisë iraniane miljarda dollarë.

- **Prej projekteve të tyre që kanë të bëjnë me përhapjen e shi'izmit gjithashtu është edhe: Shfrytëzimi i ambasadave iraniane në të gjitha shtetet, të cilat sot janë kthyer në zyrat e tyre kulturore të atashuara, si ambasada të vogla thirrjeje për në shi'izëm, nëpërmjet të cilave ato ndjekin vazhdimisht lëvizjet e shtetasve shi'itë, duke marrë përsipër çështjet e tyre, duke i mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe duke i pajisur ata me literaturë fetare dhe politike shi'ite. Kështu që asnjë ambasadë prej ambasadave iraniane nuk përjashtohet nga të qenit si populli ndjekës në lidhje me çështjen e indoktrinimit shi'it.**
- **Gjithashtu prej mënyrave të tyre për të përhapur shi'izmin është edhe: Përdorimi i armës ekonomike, joshjes me pasuri, si dhe blerja e njerëzve të autoritetshëm dhe kryeqelqve të klaneve, nëpërmjet pasurive marramendëse dhe premtimeve tunduese, me qëllim futjen e tyre në sektin e shi'izmit, duke ua përshkruar atyre sikur në Islam nuk ka asnjë dallim mes shi'itëve dhe sunive. Dhe se kjo – o vëllai im lexues – nuk është diçka e fshehtë, pasi përhapja e ndikimit shi'it, veçanërisht në Irak dhe Siri, ka qenë pikërisht nëpërmjet portës së njerëzve me pushtet dhe kryetarëve të klaneve.** [Shiko në: "Tehdhir el-Berije min Neshat esh-Shi'ah fi Surja"]
- **Prej metodave të përhapjes së shi'izmit gjithashtu, është edhe: Gjurmimi i vendeve dhe njerëzve në injorancë, si dhe vendeve të varfëra, duke u kushtuar atyre vëmendjen dhe përpjekjen e tyre, duke hapur për ta spitale, duke krijuar për ta strehime, duke përmirësuar jetën e tyre, si dhe duke u ofruar atyre përkrahje sociale, ku e gjitha kjo, me misionin e përhapjes së sektit të tyre. Për shkak të këtij mbulimi, me dashurinë për Islamin dhe dashurinë për Ehli Bejtin, të tillë njerëz të thjeshtë e të varfër, kanë hyrë në fenë e shi'izmit, grupe-grupe.**
- **Dhe se prej mënyrave më të rëndësishme të tyre në përhapjen e tarikatit të tyre është edhe: Pretendimi i marrjes përsipër të çështjes së muslimanëve, nëpërmjet mbajtjes së qëndrimeve armiqësore ndaj hebrenjve, masonëve dhe politikës perëndimore, gjë e cila ka patur një ndikim të madh në pastrimin e figurës së tyre në botën islame dhe fitimin e ndjenjave të shoqërive të mposhtura. Mirëpo afrimiteti i mullahëve të Iranit në lidhje me çështjen e Palestinës nuk është tjetër vetëm se një gudulisje ndjenjash, një interes i sektit të tyre dhe një përfitim i tyre politik. Kryetari i parlamentit iranian ka thënë:**

"Fuqia e fshehtë e Iranit është në qeveritë islamike, të cilat i shërbejnë interesit kombëtar të shteteve."
[Webfaqja e gazetës së lajmeve elektronike "Aded el-Xhumu'ah el-Hazejan"2008]

- 7 -

E kjo është një deklaratë e hapur e njërit prej kokave të politikës atje, duke deklaruar se Irani është duke ecur vetëm në interesat e vet dhe jo në interesat e Ummetit Islam, siç pretendon.

- **E prej qëndrimeve politike në përhapjen e shi'izmit është edhe:**

Bashkëpunimi me qeveritë ndërkombëtare për të goditur qeveritë sunite, të cilat nuk e dëshirojnë përhapjen e shi'izmit, aq sa qeveria e Iranit – çallmaxhinjtë e së cilës ndërkohë që bërtisnin duke mallkuar djallin e madh "Amerikën" – vazhdonte të ndërtonte marrëdhënie me qeveritë ndërkombëtare për të rrëzuar regjimin e Irakut, si dhe qeverinë e Afganistanit përpara tij, duke e deklaruar madje edhe presidenti i mëparshëm i Iranit Muhamed Ebtahij hapur këtë, duke thënë:

"Nëse nuk do të kishte qenë Irani, Amerika nuk do ta kishte çliruar Irakun, si dhe nëse nuk do të kishte qenë Irani, Amerika nuk do ta kishte çliruar Afganistanin." [Shih në librin: "Medhe te'arif an hiz'ullah?!" (Çfarë dini për

Hizbullahin?) fq.208].

- **Prej formave që shi'itë përdorin për të përhapur sektin e tyre dhe për të ngjeshur rrjeshtat e tyre është edhe:**

Lidhja e aleancave me klasat e pakënaqura, të cilat janë kundër shoqërive sunite, siç kanë qenë marksistë dikur dhe siç janë sot sekularistët. E kështu do të gjeshë se emra të tillë të refuzuar prej shoqërisë sunite, të jenë prezentë në mediat dhe forumet shi'ite, pasi këta përputhen plotësisht me ta në të njëjtin qëllim, atë të luftimit të idenditetit mbrojtës sunit. Me këto aleanca shi'itë synojnë gjithashtu edhe dobësimin e qëndrimit sunit dhe përçarjes së tyre nga brenda. Në këtë futet gjithashtu edhe: Brohoritja e shi'itëve duke përdorur disa simbole të sunitëve, të cilët për fat të keq konsistojnë si të ishin të shi'itëve, duke i shpërndarë kështu nëpërmjet fjalëve dhe fetvave të tyre, si dhe duke i përshkruar në mediat shi'ite, si simbole të unifikimit dhe barazisë.

I nderuari vëllai im lexues:

Përhapja e shi'izmit ka për të vazhduar të jetë një rrezik eventual, dhe se nga ky qëllim i tyre nuk ka për të shpëtuar asnjë vend prej vendeve Islame, veçanërisht vendet e mëdha Islame dhe ndikuese, si Egjipti i lashtë në historikun e tij dhe dijetarët e tij, Mbretëria e vendeve të shenjta (Mekes dhe Medines) e cila është e pasur me shenjtëritë dhe pasuritë që ajo ka, si dhe as toka e Sirisë së begatë, për nga pikëpamja gjeografike dhe ajo strategjike.

Kështu që këto mbeten prej shteteve më të synuara prej Rafidive shi'itë edhe nëse ata shtrihen e zgjerohen këtu dhe atje. E këtë ne nuk po e themi padrejtësisht ndaj tyre, dhe e as si akuzë shpifëse për ta, por e themi duke iu referuar monitorimit të ndjekur të skemat, fjalët dhe praktikat e tyre.

E – si shembull –le të shikojmë se çfarë kanë thënë e referencat dhe çallmat e tyre të zeza lidhur me Mbretërinë e dy vendeve të Shenjta (Meken dhe Medinen):

Ku njëri prej kollonave udhëheqëse në Teheran, autori i librit "Islami në dritën e Shi'izmit" ka thënë: *"Çdo shi'it në sipërfaqen e tokës dëshiron që Mekka dhe Medina të çlirohet dhe të fitojë lirinë, si dhe pushteti vehabist i ndyrë në ato vende të rrëzohet."*

E njëri prej çallmave të Persisë po ashtu ka thënë: *“Jua deklaroj hapur o vëllezërit e mi muslimanë që jetoni në lindje dhe në perëndim të tokës, se Mekken e Nderuar, vendin e Shenjtë të Allahut, e ka pushtuar një pakicë sunduese, të cilët janë më të këqinj edhe sesa hebrenjtë.”* [Webfaqja: “Mishkatul Islamije” (Shkëndijat Islamike)].

Ndërsa njëri prej antarëve të bllokut vendimmarrës të Bahrejnit – Hamza ed-Dijrij – ka thënë: *“Dijetarët e studiuesit e mëdhenjt të Ehli Sunnetit dhe imamllarët e Haremit (Qabes) janë thjeshtë Nasibë (rastësorë), dhe se namazi i juaj në Xhaminë e Shenjtë (Qabe) konsiderohet namaz i kryer pas një Nasibi (të rastësishmi).”* [“Sahifetul-Uakt” 15/7/2007 - nr.531]

Madje Presidenti i shkuar i Republikës Iraniane – Rafsenxhani, e ka deklaruar hapur për revistën “el-Itla’at” të datës: (14/12/1987) duke thënë tekstualisht: *“Republika Islamike e Iranit tashmë është e përgatitur ushtarakisht për të çliruar Mekken.”*

Dhe opozitari shi’it nga Kuvajti me banim në Londër – Jasir el-Habijb, në një predikim të regjistruar, bën thirrje të hapur për kryengritje dhe përballje, duke thënë: *“Mekka dhe Medina sot, janë të pushtuara, dhe se çlirimi i tyre është i domosdoshëm.”*

E, nëse janë kaq të pista qëllimet e tyre ndaj Mbretërisë së Vendeve të Shenjta (Mekkes dhe Medine) atëherë çfarë mund të thuhet për vende të tjera muslimane të nderuara?! Pra, këto janë vetëm disa prej formave dhe mënyrave të zgjerimit shi’it, si dhe diçka e pakët në lidhje me se çfarë ata kanë thënë apo kanë për qëllim, gjë të cilën e dëshmon realiteti dhe aktualiteti, si dhe e pohon shkrimi i Istinzade Raxhi’ t – në librin e tij **“el-Khutatul-Khumejnije li-Ajatur-Rafidije fij Iran”** (Projektet Humejnije të ajatullahëve Rafidij në Iran).

Tani mbetet të bëhet pyetja kryesore – vëllai im lexues - :
Çfarë mund të bëhet për t’u përballur me këtë stuhi Shi’ite dhe këtë vampirizëm Safavit (spastrues)?!

I nderuari vëllai im lexues:

Prej obligimeve fetare, është edhe këshillimi i muslimanëve dhe përballja me devijimin Rafidij, me anë të gjuhës dhe pasurisë, si dhe ndërgjegjësimi e muslimanëve në lidhje me rrezikun e kësaj shtrirjeje, në mënyrë që të mbrojnë dhe ruajnë fenë e vet prej tyre.

Nëse ne nuk do të lëvizim me vendosmëri dhe të bindur, përpara kësaj Tsunami shi’it, atëherë përmbytja e tij është duke ardhur për çdo vend, pa përjashtuar asnjë prej tyre. Kështu që çdo musliman xheloz e ka për obligim që ta mbrojë fenë e vet dhe ta ndihmojë rrugën e vet, me të tëra mundësitë dhe aftësitë që ka. E këto janë disa prej gjërave që ne kemi mundësi për t’i bërë, të cilat po i përmbledhim si më poshtë:

Së pari: Puna serioze në përhapjen e rrugës së Ehli Sunnetit në botën Islame, si dhe mbështetja financiare e thirrësve dhe shoqatave që punojnë në realizimin e këtij qëllimi.

Së dyti: Përhapja e lëndëve informuese të shkruara, auditive dhe vizive, të cilat nxjerrin në pah të këqiat e shi’izmit, duke e sqaruar të vërtetën në lidhje me ideologjinë e tyre.

Së treti: Përqëndrimi në studimin Akides (bazave të besimit) së Ehli Sunnetit, përforcimi i saj në mesin shoqërive Sunite, vlerësimin e Sahabëve – Allahu qoftë i kënaqur me ta! -, si dhe kundërpërgjigja ndaj çdo dyshimi që vjen nga Rafiditë Shi'a duke lënë ndikimin e tyre rreth vetes.

Së katërti: Të pajtohemi e të tregohemi të bashkuar, përkundër mospajttimeve në mesin tonë, veçanërisht ata që janë aktivë në fushën e davetit Islam, duke i bashkuar rreshtat dhe fjalët në përhapjen dhe përforcimin e rrugës së Ehli Sunnetit, pasi kundërshtitë tona janë shkak i përçarjes dhe i dobësimit tonë, gjë e cila nuk është në interes vetëm se të palës që nuk na duan.

Së pesti: Duhet që shtetet sunite islame të fuqizohen në autonominë e tyre si dhe të angazhohen për të zotëruar fuqi me të cilën t'i kundërvihen pangopësisë perse ndaj vendeve Islame sunite, pasi llogjika e sotme është llogjika e të fortit, dhe se bota e sotme rrespekton vetëm ata që janë të fuqishëm, veçanërisht kur ne sot shikojmë armiqtë që po i mprehin thikat e tyre, e po i shfaqin fuqitë e tyre ditë pas dite.

Së gjashti: Thirrësit, njerëzit e mediatikë dhe biznesmenët muslimanë, e kanë për obligim dhe përgjegjësi krijimin e kanaleve televizive për t'iu kundërpërgjigjur kanaleve televizive shi'ite me natyrën e tyre tipike sektare, pasi epoka jonë është epokë mediatike dhe se arma mediatike është më ndikuesja dhe më e përhapura sot.

Së shtati: Ndjekësit e rrugës së Sunnetit profetik e kanë përgjegjësi dhe obligim që ta tregojnë kulturën, akiden dhe rrugën e Rafidive Shi'itë, duke u mbështetur në referencat që sektet e tyre i konsideron si të besueshme, si dhe t'i nxjerrin në pah pabesitë e tyre të kryera përgjatë historisë, bashkë me mllefin që ata kanë ndaj Ummetit islam, me pretendimin e tyre se vetëm ata janë që do e sjellin unifikimin dhe bashkimin e muslimanëve.

Së teti: Ndjekësit e rrugës së Ehli Sunneti e kanë obligim dhe përgjegjësi që ta njohin mirë historinë e vet dhe rrugën e vet të gjatë në ruajtjen e Akides (bazave të besimit) së Ummetit, Unitetin e tij, simboleve të shenjta të tij, si dhe ta dijnë se çdo përhapje e Islamit në vendet që sot janë në duart e tyre është arritur vetëm prej atyreve vetë.

*** Për më tepër, në lidhje me sqarimin e akides së Shi'izmit Imamij dhe devijimit të tyre, ktheju librave në vijim:**

1- "Euxhezul-khitab fii Bejan meukifush-Shi'ah minel-As'hab"

(Një përmbledje sqaruese mbi qëndimin e Shi'ave ndaj Sahabëve).

2- "Min akadish-Shi'ah"

(Prej akides së Shi'ave).

3- "esh-Shi'ah Ithna'asherije ue tekfiruhum el-Umumul-Muslimijn"

(Shi'itët Ithna'asherij dhe konsiderimi i muslimanëve mohues nga ana e tyre).

4- "el-Meshru'ul-Iranij es-Safauij"

(Projekti Safavit i Iranit).

Të cilat mund t'i geshë bashkë me shumë të tjera në linkun e faqes së më pashtme:

www.dsbook.dd-sunnah.net

E lusim Allahun e Lartmadhëruar që të na e ruajë fenë tonë, sigurinë tonë dhe besimin tonë, si dhe të na mbrojë prej të keqes së armiqve tanë dhe atyre që na duan të keqen.